



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 41 Datë 02.06.2023

VERIFIKIM SI REZULTAT I INDICIEVE NGA ORGANET AUDITUESE

Autoriteti kontraktor	BASHKIA BERAT
Organi auditues	KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Numri i procedurave të audituara	10 (dhjetë) Procedura
Lloji i procedurave të audituara	“Kërkesë për propozim”: 2 (dy). “Procedurë e Hapur”: 6 (gjashtë). “Shërbim Konsulence”: 2 (dy).
Konstatimet kryesore	1. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me nenin 23, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar (në fuqi në kohën e zhvillimit të procedurave), lidhur me hartimin e specifikimeve teknike, në procedurat e prokurimit të audituara. 2. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me nenin 28, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar (në fuqi në kohën e zhvillimit të procedurave), lidhur me përllogaritjen e fondit limit, në procedurat e prokurimit të audituara. 3. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me nenin 46, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar (në fuqi në kohën e zhvillimit të procedurave), lidhur me hartimin dhe argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, në procedurat e prokurimit të audituara. 4. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me nenin 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe me nenin 92, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (në fuqi në kohën e zhvillimit të procedurave), lidhur me kualifikimin e operatorëve pjesëmarrës, në procedurat e prokurimit të audituara.
Masat e marra	Në bazë të nenit 23/e dhe nenit 132, pikat 1/c/ç/g/gj dhe 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, APP vendosi të propozojë marrjen e masës disiplinore ndaj 4 (katër) personave dhe të dënojë me gjobë 11 (njëmbëdhjetë) persona, të evidentuar përgjegjës për shkelje dhe mangësi të konstatuara në vendim.